

Planifikimi i mësimit për lëndën e lirë zgjedhore - FOTOGRAFIA për Kl.VI

TË DHËNA ELEMENTARE PËR PROGRAMIN MËSIMOR:

<i>Lënda zgjedhore:</i>	<i>Fotografia</i>
<i>Përpiloi:</i>	<i>Armend Imeri</i>
<i>Shkolla:</i>	<i>Sh.F.K."Përparimi"-Reçicë e Madhe, Tetovë</i>
<i>Kategoria e lëndës mësimore:</i>	<i>Lëndë e lirë zgjedhore për të mbështetur interesat e nxënësve që nuk janë pjesë e programeve mësimore</i>
<i>Klasa:</i>	<i>VI (e gjashtë)</i>
<i>Temat/fushat mësimore në programin mësimor:</i>	<ul style="list-style-type: none">• <i>Fotografia</i>• <i>Përpunimi i fotografisë</i>
<i>Numri i orëve:</i>	2 orë javore/ 36 orë vjetore
<i>Mjetet dhe pajisjet:</i>	-Mjete audiovizuale (fotoaparati, LCD-projektor, kamerë digjitale, kompjuter, tabelë intelegjente, tablet, printer dhe pajisje tjera digjitale); -Internet, Softwerë mësimorë; -Mjete dhe materiale fotografike (letër e fotondjeshme, tretës acidik, fiksativ, llampë me reze infra të kuqe, enë speciale për zhvillim, pincetë, etj,,, -Mjete vizuale (vizatime, fotografi, punime, revista, libra, pankarta, postera, aplikacione, ilustrime, prospekte);

Plani mësimor për Lëndën e lirë zgjedhore: Fotografia për klasën e VI

NDËRLIDHJE ME STANDARDET KOMBËTARE

-Programi mësimor parasheh kompetenca relevante nga fusha: Shprehja artistike dhe kultura nga standardet kombëtare:

Nxënësi / nxënësjë din dhe / ose mund :

VIII - A.1	të manifestojnë njohuri të formave të ndryshme të shprehjes artistike nga të gjitha fushat e kulturës (letërsisë, muzikës, arteve vizuale, arteve skenike, arteve dekorative, arkitekturës, dizajnit);
VIII - A.3	të shprehin idetë, përvojat dhe emocionet e tyre duke përdorur forma artistike ose forma të tjera të shprehjes krijuese (individuale ose kolektive);
VIII - A.9	të njohin dhe shpjegojnë sesi kultura së cilës i përkasin (përfshirë traditën dhe fenë) ndikoi në formimin e identitetit të tij / saj dhe botëkuptimit;
VIII - A.12	ta interpretojnë botën jo vetëm nga këndvështrimi i anëtarëve të kulturës së tyre, por edhe nga perspektiva e kulturave të tjera.

Nxënësi / nxënësjë kupton dhe pranon që:

VIII – B.1	arti dhe format e tjera të shprehjes kulturore kontribuojnë në kuptimin dhe ndryshimin e botës;
VIII – B.2	qëndrimi kritik ndaj produkteve të ndryshme të artit është i rëndësishëm për zhvillimin e vlerave estetike individuale dhe shoqërore;
VIII – B.3	respektimi dhe promovimi i kulturës së vet kontribuon në forcimin e identitetit dhe dinjitetit kulturor;
VIII – B.6	respektimi dhe promovimi i kulturave të tjera kontribuon në sigurimin e respektit për kulturën e vet nga të tjerët.

Programi mësimor parasheh edhe kompetenca relevante plotësuese edhe nga përmbajtjet tjera të Standardeve kombëtare:

Shkrim-leximi digjital, Zhvillimi personal dhe social, Shoqëria dhe kultura demokratike dhe teknika, teknologjia dhe sipërmarrja.

Nxënësi / nxënësjë din dhe / ose mund:

<i>IV – A.3</i>	<i>përdor mënyra të ndryshme për të organizuar dhe ruajtur si dhe shpërndarë në mënyrë të sigurt përmbajtjen në pajisje dhe rrjete të ndryshme në mjedisin digjital;</i>
<i>IV – A.9</i>	<i>në komunikimin me të tjerët në hapësirën digjitale multikulturore, i respekton pjesëmarrësit e ndryshëm dhe ndjek normat ligjore, kulturore dhe etike në sjelljen në hapësirën digjitale;</i>
<i>IV – A.10</i>	<i>të kujdeset për identitetin e vet digjital, sigurinë dhe reputacionin si dhe t'i respektojë politikën e privatësisë;</i>
<i>V – A.7</i>	<i>t'i shfrytëzojë përvojat personale që ta lehtësojë mësimnxënien dhe ta përshtatur sjelljen individuale në të ardhmen;</i>
<i>VI – A.2</i>	<i>të analizojë sjelljen e vet në mënyrë që të përmirësojë vetveten, duke vendosur qëllime reale dhe të arritshme për veprim aktiv në komunitet;</i>
<i>VI – A.4</i>	<i>të bëjë reflektime kritike mbi vlerat dhe sjelljet e ndryshme personale dhe shoqërore në kontekste të ndryshme (sidomos në situata të ndjeshme etike), të respektojë normat dhe vlerat e pranuar shoqërisht, por edhe t'i sfidojë ato kur ai mendon se është e nevojshme;</i>
<i>VI – A.8</i>	<i>të vështrojnë çka i ndërlidh, e çka i dallon njerëzit e komuniteteve, të gjejë mënyrë që të kontribuojë për përparimin e bashkësisë, duke i pasur parasysh nevojat dhe interesat e tyre;</i>
<i>VI – A.12</i>	<i>të analizojë dhe diskutojë në mënyrë kritike vlerat e shoqërisë civile, rolet dhe sjelljet e ndryshme të qytetarëve dhe rolin e tyre në të;</i>
<i>VI – A.17</i>	<i>të analizojë ndikimin e mediave të shtypura, elektronike dhe sociale në opinionin publik dhe zgjedhin burime të besueshme informatash mbi të cilat do të mbështesin pikëpamjet e tyre;</i>
<i>VII – A.1</i>	<i>t'i ndërlidhë njohuritë e shkencës me zbatimin e tyre në teknikë dhe teknologji dhe me jetën e përditshme;</i>
<i>VII – A.3</i>	<i>të shpjegojë se si sistemet / produktet e përparuar teknike dhe teknologjike përmirësojnë jetën e përditshme të njerëzve;</i>
<i>VII – A.8</i>	<i>për të hartuar dhe zbatuar një fushatë reklamuese për një produkt të caktuar duke përdorur një logo, parullë, prezantim, faqe në internet, etj.</i>

Nxënësi / nxënësjë kupton dhe pranon që:

<i>III – B.8</i>	<i>çdo individ është përgjegjës për ruajtjen e mjedisit natyror në mjedisin e afërt dhe më gjerë dhe që ai duhet të zhvillojë vetëdijen mjedisore dhe të veprojë në drejtim të mbrojtjes dhe qëndrueshmërisë së mjedisit;</i>
<i>IV – B.6</i> <i>V – B.10</i>	<i>të drejtat e pronësisë intelektuale të produkteve në dispozicion në rrjetet digjitale duhet të respektohen; mësimi është një proces i vazhdueshëm që nuk përfundon në shkollë dhe nuk kufizohet vetëm në arsimin formal.</i>

REZULTATET E MËSIMIT

Tema 1 : Fotografia

Orët e përgjithshme: 28

Njohuri/ Shkathtësi :

- Kupton çfarë është fotografia dhe do të mund të shpjegojë momentet kyçe nga historiku i fotografisë;
- Mund të përdorë pjesët themelore të kamerës dhe do të mund të shpjegojë ndikimin e tyre mbi fotografinë;
- Njohtohet me faktin se teknika antike fotografike **Camera Obscura** i paraprin fotografisë ashtu siç e njohim sot;
- Identifikon shembuj nga bota reale ku aplikohen rregullat e kompozicionit (p.sh., fotografi peizazhi me vija drejtuese ose portret me kuadrat);
- Mund të krahasojë fotografitë dhe të diskutojë se cilat tone dhe kontraste e përcjellin më së miri efektin e dëshiruar;
- Di të shfrytëzoj burime të ndryshme të dritës (p.sh., dritën anësore), për të theksuar përmbajtjen e fotografisë;
- Fiton njohuri dhe në praktikë mund të kombinojë ngjyrat, konturat dhe siluetat për të krijuar fotografi kreative;
- Mund të përshkruajë se si perspektivat e ndryshme mund të sjellin ndryshimin e mënyrës se si shikuesi e përjeton fotografinë;
- Mund të hulumtojë fotograf të njohur dhe të ndërtojë stil personal të fotografimit;
- Bën dallimin midis llojeve të baraspeshave, për të kuptuar se cila teknikë është më e përshtatshme në situata të caktuara;
- I shpjegon dallimet ndërmjet portretit në enterier dhe eksterier;
- Mundet të krijojë një fotoese përmes së cilës në mënyrë vizuale dhe kreative rrëfen një histori ose përcjell një mesazh.

Qëndrimet/ Vlerat :

- E kupton rolin e fotografisë si art dhe teknologji;
- Pranon rëndësinë se fotografia e mirë kërkon ekuilibër midis artit dhe shkathtësive teknike;
- Mendon se kontrasti ndihmon në tërheqjen e vëmendjes së shikuesit drejt objektit kryesor;
- Ka një qëndrim pozitiv që tekstura nuk është vetëm një element estetik, por edhe mjet për të përcjellë emocione dhe mesazhe në fotografi;
- Respekton qëndrimin se ngjyra është mjet për shprehje personale kreative dhe jo vetëm shtesë estetike;
- Pranon se zgjedhja e këndit dhe perspektivës së duhur, mund të ndryshojë ndjenjën që e përçon fotografia;
- E gjykon zbatimin jokonsistent të perspektivës që dëmton integritetin vizual të fotografisë;
- Beson se fotografimi në eksterier do ta nxisë që ta vlerësojë bukurinë e natyrës dhe rëndësinë e saj për artin;
- Mbështet qëndrimin etik drejt përdorimit të fotografisë për edukim, aktivizëm ose informim;
- Është i gatshëm që të ndërmerr aktivitete që i mundësojnë më lehtë të tejkalojë temat

Përmbajtjet (dhe nocionet)	Numri i orëve	Shembuj të aktiviteteve:
<p>Prezantim dhe njohje me lëndën e Fotografisë, fotoaparatin, përdorimi dhe aplikimi i tyre, bazat e fotografisë (Roli dhe rëndësia e fotografisë në jetën moderne)</p> <p><i>(fotografija)</i></p>	2	<ul style="list-style-type: none"> Nxënësit njohtohen me lëndën e Fotografisë, fazat e ndarjes në kapituj të ndryshëm në Fotografi dhe Përpunimi i fotografisë. Nxënësit ndjekin prezantim, me anë të sllajdeve historikun e shkurtër të fotografisë që nga filltet e saj e gjer më sot, iu sqarohet çfarë është fotografia, i njohtoj me fotoaparatin dhe funksionimin e tij .
<p>Karakteristikat fotografike: Ekspozicioni, Lenta (objektivi) dhe ISO</p> <p><i>(Objektiv normal ,këndgjërë, zgjatës, telefoto)</i></p>	2	<ul style="list-style-type: none"> Nxënësit ndjekin një mësim të shkurtër ku iu sqarohen karakteristikat fotografike : Ekspozicioni, Lente(Objektivi) dhe ISO. Në vazhdim nxënësit të ndarë në grupe do realizojnë aktivitete si p.sh. për njërin grup të krahasojnë dy fotografi : një me ekspozim të shkurtër dhe një me ekspozim të gjatë dhe te shpjegojnë se si ndikon koha e ekspozimit në pamjen e fotografisë. Aktiviteti i grupës së dytë do jetë : Fotografoni të njëjtin objekt me hapje të ndryshme të lentës (p.sh., f/2.8, f/8, f/16), krahasoni fotografitë dhe përshkruani si ndryshon thellësia e fushës. Grupit të tretë do iu jepet detyrë të fotografojnë në një dhomë të errët me cilësime të ndryshme të ISO-s (100, 800, 1600). Krahasoni rezultatet dhe shpjegoni si ndikon ISO në cilësinë e fotografisë. Pasi që nxënësit kanë kuptuar karakteristikat fotografike gjatë orës mësimore do t’iu jepet detyrë që nëpërmjet dëgjimit të një melodie nga ndonjë artist si p.sh. VERDI - Marcia Trionfale, të arrijnë të kuptojnë domethënien se sa e rëndësishme është gjendja momentale psikologjike në krijimin e një vepre artistike,(fotografike).
<p>kamera obskura</p> <p><i>(Dhoma e errët, fiksativ, tretësi Letër e fotondjeshme, zhvillim i fotografisë)</i></p>	2	<ul style="list-style-type: none"> Nxënësit ndjekin prezantim dhe demonstrim për teknikën e lashtë të quajtur CAMERA OBSCURA apo në përkthim dhoma e errët. Detyrë për nxënësit do jetë që të ndahen në grupe të vogla me nga katër nxënës, duke shfrytëzuar kuti nga kartuqët të cilët e kanë humbur funksionalitetin, ti ngjyrosin me ngjyrë të zezë, i mbështjellin mirë që mos depërtoj drita, më pastaj nga njëra anë e kutsisë hapin një vrimë të vogël me gjilpërë, për të fotografuar. Me ndihmën e arsimtarit ata zhvillojnë teknikën Camera Obscura në një hapësirë të errët duke transferuar imazhe në një objekt me sipërfaqe të rafshët në letër të fotondjeshme . Pas demonstrimit të aktivitetit, nxënësit bisedojnë dhe tregojnë çfarë kanë vërejtur rreth funksionimit për Camera Obscura dhe si koncepti i këtij shembulli solli deri në zhvillimin e kamerave moderne.
<p>Kompozicioni tek fotografia</p>	2	<ul style="list-style-type: none"> Nxënësve iu sqarohen llojet e kompozicioneve, efektet artistike dhe psikologjike se si ndikojnë tek vëzhguesi, si dhe rregulli antik Ndarja në të tretën, ku iu paraqes shembuj nga artistët : Leonardo da Vinçi, Vincent Van Gogh, shembuj nga arkitektura e vjetër

<p><i>(Prerje e artë, kompozicion vertikal, horizontal, diagonal, piramidal)</i></p>		<p>greke siç është Partenoni dhe aplikimi i ndarjes së artë në jetën e përditshme. Pastaj nxënësit do marrin nga një fletë të bardhë me rrjetë sipas rregullit të tretave dhe do të duhet të vizatojnë se ku do ta vendosin kompozicionin, për shembull : një pamje peizazhi me një rrugë që të çon në male në distancë.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Detyrë e nxënësve do jetë që të dalim në natyrë dhe të fotografojmë Peizazh, duke zbatuar ndarjen e artë. Më pastaj në ambient të klasës diskutojmë për fotografitë e realizuara nga nxënësit .
<p>Toni dhe kontrasti Fotografia bardhë e zi</p> <p><i>(Kontrast i ulët, kontrast i fortë, ekspozicion perfekt)</i></p>	2	<ul style="list-style-type: none"> • Në një bisedë të hapur definohen konceptet për tonin dhe kontrastin dhe si ata janë të lidhura me fotografinë. Nxënësit do të vëzhgojnë dy fotografi: njëra me kontrast të lartë dhe një me kontrast të ulët, ku do të duhet të gjejnë se cila nga fotografitë ka kontrast të lartë dhe pse? • Më pas nxënësit do kenë për detyrë të simulojnë kontrastin duke përdorur softuer të thjeshtë për redaktimin e fotografive (ose do të punojnë me shembuj të gatshëm) që ti zmadhojnë apo ulin kontrastet dhe tonet. Pastaj nisim një diskutim : Çfarë ndyshon tek atmosfera e fotografisë kur rrisim apo ulim kontrastin? • Nxënësit nëpërmjet detyrës praktike që e realizojnë përreth oborit të shkollës realizojnë fotografi bardhë e zi e më pastaj i dërgojnë në e-mailin e lëndës punimet e tyre që bashkarisht ti analizojmë efektet e kontrastit të ulët dhe të fortë.
<p>Tekstura tek fotografia</p> <p><i>(Teksurë natyrore, artificiale, burimi i dritës)</i></p>	2	<ul style="list-style-type: none"> • Nxënësit ndjekin prezantim përmes së cilës ata njohtohen me nocionin teksturë, iu sqarohet se si tekstura ndikon në pamjen dhe në ndjesinë që përcjell fotografia, si dhe tekstura tek fotografia përfitohet kur burimi i dritës vjen nga ana e objektit për fotografim. Nxënësit do kenë për detyrë të analizojnë një fotografi që përmban teksturë të theksuar dhe të përshkruajnë se si tekstura ndihmon në krijimin e atmosferës dhe efektit vizual. • Nxënësit, të udhëhequr nga mësimdhënësi, do të dalin në mjedisin e shkollës për të realizuar detyrën praktike, teksturën me një varg fotografish me temë: “Të shprehim anët pozitive dhe negative ndaj shkollës tonë”, duke shfrytëzuar ndriçimin anësor, më pastaj i dërgojnë në e-mailin e lëndës punimet e tyre, ku bashkërisht do të krahasojmë dy fotografi të të njëjtit objekt me ndriçime të ndryshme dhe të shpjegojnë se cila e thekson më shumë teksturën.
<p>Ngjyra, kontura dhe silueta</p> <p><i>(Spektri i ngjyrave, teoria e ngjyrave)</i></p>	2	<ul style="list-style-type: none"> • Nxënësit, të ndarë në grupe të vogla, hulumtojnë në internet për konceptet bazë të lidhura me ngjyrën, konturën dhe siluetën. Pastaj kanë detyrë të shpjegojnë si ndikojnë ngjyra, kontura dhe silueta në estetikën dhe rëndësinë e fotografisë. • Pasi që nxënësit do mundin të identifikojnë dhe shpjegojnë për ngjyrën, konturën dhe

		<p>siluetën, njëri grup do ketë aktivitet të realizojë fotografi siluete duke vendosur një objekt para burimit të dritës (p.sh., perëndimin e diellit) dhe ta shpjegojnë procesin. Grupi tjetër do ketë detyrë të realizoj fotografi me kontrast të theksuar komplementar (p.sh., e kuqe dhe jeshile, blu dhe portokalli). Ndërsa grupi i tretë do ketë detyrë të shfrytëzojnë dritën për të krijuar kontura të qarta të objekteve tek fotografitë e tyre.</p>
<p>Perspektiva tek fotografia</p> <p>(Perspektiva lineare, perspektiva ajrore, optike, perspektiva e zogut dhe e bretkosës)</p>	2	<ul style="list-style-type: none"> Nxënësve iu prezentohen shembuj nga perspektiva të ndryshme, prej fotografive ose ilustrimeve, nga të cilat do të mësojnë ti identifikojnë llojet themelore të perspektivave: lineare, ajrore, perspektivën e zogut dhe të bretkosës. Pastaj diskutohet se si perspektiva lineare e orienton shikimin kah pika në zhdukje ose si perspektiva ajrore e përcjellë ndjesinë e largësisë. Pas përfundimit të diskutimit nxënësit do kenë detyrë të zbatojnë teknika të perspektivave që të krijojnë fotografi vizuale interesante, për shembull: Fotografoni skenë me perspektive lineare (një rrugë ose rrugicë që ngushtohet kah pika në zhdukje) ose të realizojnë fotografi me perspektivën e bretkosës (fotografimi i njerëzve nga poshtë që të duken të fuqishëm ose dominant). Në fund do të analizojmë dy fotografi të nxënësve që kanë aplikuar lloje të ndryshme të perspektivave (për shembull: lineare dhe të bretkosës) dhe do të krahasojmë se si secili lloj i perspektivës ndikon mbi thellësinë dhe hapësirën në fotografi.
<p>Peizazhi tek fotografia</p> <p>(Fotografi peizazhi për kartolina, libra, turizëm, filtra, kamera panoramike, rregulli i të tretave, mesi i artë, ora e artë,)</p>	2	<ul style="list-style-type: none"> Nxënësit ndjekin prezentim çfarë nënkupton me termin peizazh si disiplinë fotografike, e cila më së miri na paraqitet duke vrotuar me mjaft kujdes natyrën. Ata do të mbajnë mend dhe do të kuptojnë se Kompozicioni (rregulli i të tretave, ndarja e artë), Drita (ora e artë), dhe Elementet në plan të parë, plan të mesëm dhe në sfond janë tre konceptet kryesore tek fotografia peizazhiste. Nxënësit do të kenë detyrë të fotografojnë peizazh me fokus në orën e artë (në agim ose para perëndimit të diellit, kur drita e diellit është më e butë, më e ngrohtë dhe më e shpërndarë, duke krijuar kushte ideale për fotografim), dhe të zbatojnë rregullin e të tretave. Nxënësit analizojnë peisazhe nga autorë të ndryshëm, siç janë Ansel Adams, Arno Rafael Minnkinen, Franko Fontana, Andreas Gurski si dhe krahasojnë fotografitë e tyre me shembujt e lartëpërmendur dhe do të përcaktojnë se çfarë mund të përmirësohet.
<p>Baraspesha tek fotografia</p> <p>(Simetri, asimetri, baraspeshë radiale)</p>	2	<ul style="list-style-type: none"> Nxënësit ndjekin prezentim përmes të cilit njihen me konceptin baraspeshë, do ti identifikojnë llojet themelore të baraspeshës tek fotografia. Nxënësit të ndarë në grupe, do të zbatojnë lloje të ndryshme të baraspeshës tek fotografitë e tyre, për shembull: realizoni baraspeshë simetrike ose asimetrike

		<p>(arkitekturë ose peizazh me reflektim), ose të krijojnë fotografi me baraspeshë radiale, ku elementet janë të shpërndara rreth pikës qendrore.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Pastaj, secili grup prezenton. Në përfundim, nxënësit krahasojnë fotografitë dhe vlerësojnë se cili lloj i baraspeshës tërheq më shumë vëmendje dhe pse?
<p>Portreti në enterier dhe eksterier</p> <p><i>(Portret formal, joformal, spontan, ambiental, konceptual, autoportret)</i> Ambient (I ngrohtë / I ftohtë) Studio (flic) Eksterier (e hapur / e mbyllur)</p>	4	<ul style="list-style-type: none"> • Nxënësit ndjekin prezantim vizual për portretin si disiplinë mjaft e rëndësishme fotografike, llojet e portreteve, ndarja e kompozicionit tek portretet, si dhe efekti psikologjik i kuadrit në raport me modelin. Prezantim me fotografë të njohur portretist siç janë : Joulia Margaret Cameron, Jousouf Karsh, Richard Avedon, Steve McCurry si dhe fotografin e njohur maqedonas Dragi Nedelcevski dhe diskutojnë për dallimet midis portreteve të realizuara në enterier dhe eksterier. • Detyrë e nxënësve do jetë që të fotografojnë me temë : “Shoku im më i mirë” duke përshkruar karakterin e tij/saj, aktivitetet profesionale, interesat private, përmes llojeve të portreteve, si dhe të japin vlerësim se si sfondet e ndryshme (urbane ose natyrore) e ndryshojnë karakterin e portretit dhe cila prej tyre e pasqyron më mirë modelin. • Si aktivitet tjetër do të kemi në bashkëpunim me UEJL të shfrytëzojmë hapësirat e studios së tyre artistike ose në ndonjë studio fotografike me qëllim që të realizojmë detyrën Portreti në enterier, duke zbatuar teknika dhe elemente të ndryshme. • Si një aktivitet tjetër do të kemi në bashkëpunim me UEJL duke përdorur studion e tyre të artit, ose një studio fotografike për të realizuar detyrën e realizimit të një Portreti në një interier duke përdorur teknika dhe elemente të ndryshme.
<p>Fotografi dokumentare</p> <p><i>(Fotolajm, fotografi dokumentare sociale, peizazh dokumentar, foto lajm, foto esse, fotografi sportive)</i></p>	2	<ul style="list-style-type: none"> • Nxënësit ndjekin prezantim vizual me fotografi ku ata njohtohen me konceptet bazë të fotografisë dokumentare. Ata njohin fotografë të njohur që punojnë në këtë zhanër (p.sh., Sebastião Salgado, Dorothea Lange), dhe identifikojnë lloje të ndryshme nga fotografia dokumentare siç janë: foto lajmi, foto esse, fotografi rruge, peizazhi dokumentar, fotogazetaria, etj. Përmes bisedës, ata arrijnë në përfundimin se fotografia dokumentare tregon një histori ose përcjell një mesazh. • Nxënësit të ndarë në grupe do kenë detyrë të realizojnë foto esse me temë, për shembull : "Jeta në lagjen time" (Tregim i historive përmes fotografive), "Riciklimi dhe ekologjia" dhe "Një ditë në jetën e..." dhe të prezantojnë punimet e tyre. Në fund, nxënësit bëjnë krahasimin e fotografive me qasje të ndryshme ndaj zhanrit dokumentar dhe arrijnë në përfundime për suksesin e tyre.
<p>Vlerësimi estetik i punimeve, Aranzhimi i punimeve</p>	2	<ul style="list-style-type: none"> • Nxënësit analizojnë punime të shokëve të tyre (nga aspekti teknik dhe estetik) të realizuara nga temat e lartëpërmendura, si dhe bashkëbisedojnë me arsimtarin se ku i kanë pikat e forta dhe ku kanë mundur që të jenë akoma më kreativ në punimet e tyre.

(Kritika, interpretimi, përshkrimi i fotografisë)		<ul style="list-style-type: none"> Nxënësit zgjedhin 3-5 fotografi që më mirë përfaqësojnë aftësitë dhe konceptet e tyre, për printimin e punimeve më të suksesshme, me qëllim që të përgatisin një ekspozitë grupore në ambientin shkollor. Për çdo fotografi ata shënojnë një përshkrim të shkurtër që shpjegon idenë, teknikën dhe mesazhin.
---	--	--

Tema 2: Përpunimi i fotografisë Orët e përgjithshme: 8 orë	
Njohuri/ Shkathtësi:	
<ul style="list-style-type: none"> Mund t'i njohë mjetet dhe teknikat bazë për redaktimin e fotografive; Mundet që t'i përdorë mjetet si Crop Tool, Move Tool dhe Transform Tool për redaktimin e fotografive; Kupton se si të kombinojë ngjyrën dhe teksturën për të arritur harmoni; Identifikon mundësi për të eksperimentuar me efekte dhe stile të reja. 	

Qëndrimet/ Vlerat :	
<ul style="list-style-type: none"> Pranon rëndësinë e postproduksionit si pjesë e procesit të krijimit të fotografive; Respekton rregullat e kompozicionit vizual (rregulli i të tretave, ndarja e artë) si bazë themelore e krijimtarisë; Mbështet bashkëpunim dhe shkëmbim të ideve në grup për arritje të zgjidhjeve më të mira; Beson se estetika luan rol kyç në komunikimin përmes mediave vizuale. 	

Përmbajtjet (dhe nocionet)	Numri i orëve	Shembuj të aktiviteteve:
Bazat e postproduksionit dhe hyrje në estetikë <i>(Adobe photoshop, light room, përpunim i fotografisë, fotografi digjitale, retushim i detajeve)</i>	2	<ul style="list-style-type: none"> Nxënësve iu shtrohet pyetja se çfarë do të thotë postproduksioni në fotografi dhe nëse ata vetë kanë përpunuar ndonjë fotografi? Iu sqarohet se cili është qëllimi i përpunimit të fotografive, etapat e përpunimit të fotografisë, çfarë është estetika, iu tregohen nxënësve epoka të ndryshme artistike dhe fotografike. Nxënësit ndjekin prezantim vizual për metodologjinë e përpunimit në faza të fotografisë, në programin kompjuterik Adobe Photoshop, si dhe hapet një bisedë në lidhje me krahasimin e dy fotografive para dhe pas përpunimit, ku nxënësit shpjegojnë ndryshimet e vërejtura.

<p>Hapësira dhe kompozicioni</p> <p><i>(Grafikë rasterike dhe vektoriale, piksel, formate JPG/RAW/PSD, Transofm Tool, Move Tool, Crop Tool)</i></p>	2	<ul style="list-style-type: none"> Mësimdhënësi i njohton nxënësit me mjetet punuese në Photoshop që përdoren për përpunimin e hapësirës dhe kompozicionit (si Crop Tool, Move Tool dhe Transform Tool). Pas shfaqjes së shembujve nga fotografitë e përpunuara dhe atyre origjinale nxënësit shpjegojnë konceptet si "rregulli i të tretave", "hapësira negative", "pika qendrore" dhe "ndarja e artë, duke treguar se si ndryshimet e bëra kanë përmirësuar kompozicionin. Detyrë praktike nxënësit do të kenë që nëpërmjet përdorimit të mjeteve Crop Tool, Move Tool dhe Transform Tool, të zbatojnë rregullin e të tretave, për kornizimin e fotografive, zhvendosjen e elementeve dhe arritjen e baraspeshës.
<p>Ngjyra dhe tekstura</p> <p><i>(Teoria e ngjyrave, psikologjia e ngjyrave, Korigjimi i ngjyrave-Image-Lasso Tool/ Magic Wand Tool Hue/Saturation, Color Picker Brush Tool, Clipping Masks)</i></p>	2	<ul style="list-style-type: none"> Nxënësit ndjekin një video ose një demonstrim për selektimin, ndryshimin e ngjyrave dhe teksturës. Ata emërtojnë dhe identifikojnë mjetet për selektim (Lasso Tool, Magic Wand Tool), për ndryshimin e ngjyrave (Color Picker, Gradient Tool, Hue/Saturation) dhe për teksturë (Brush Tool, Pattern Fill, Clipping Masks). Pas përfundimit të diskutimit, detyrë nxënësit do të kenë që të aplikojnë Color Picker dhe Gradient Tool, për të krijuar paletë harmonike të ngjyrave në Photoshop ose Clipping Masks për të shtuar teksturë në shtresa të ndryshme të fotografive. Nxënësit analizojnë se si ngjyrat dhe teksturat e ndryshme janë harmonizuar për të krijuar një stil ose atmosferë të caktuar.
<p>Vlerësimi estetik i punimeve, Ekspozitë grupore</p> <p><i>(Printim, titulli i ekspozitës, kuratorë, hapësira e ekspozitës, prezantimi dhe përshkrimi i fotografive, kritika)</i></p>	2	<ul style="list-style-type: none"> Punimet e zgjedhura nga tema e fotografisë që janë të papërpunuara, nxënësit do të kenë për detyrë t'i përpunojnë në Photoshop për të përshtatur ngjyrat, teksturën, kontrastin dhe kompozicionin. Secila fotografi duhet të ketë një përshkrim të shkurtër që do të shpjegojë idenë, teknikat dhe mesazhin që ajo përcjell. Pas përpunimit, fotografitë i printojmë, do të zgjedhim një titull të shkurtër për ekspozitën, dhe në ambient të shkollës organizojmë ekspozitë grupore, ku nxënësit do të prezantojnë punimet e tyre dhe do të shpjegojnë procesin e krijimit të tyre. Pas përfundimit të ekspozitës, organizojmë diskutim me nxënësit për të reflektuar mbi suksesin dhe eksperiencën e tyre.